



Komuna e Shtimës

Zyra e Prokurimit

Nr. 03/01/088

Datë 16/12/2020

KONTRATË PËR FURNIZIM

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson: Muhadin Halili , Drejtor i Prokurimit në njërën anë:

dhe

"GRYKA" SH.P.K., Rr Anton Çeta, 72000, Shtime, Kosovë që e përfaqëson Z. Bajram Avdyli , tel. 044/ 287- 412 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

“ Furnizimi -Tepih dhe Perde për hapjen e objektit të ri të I.P “Albiona Asllani”- Shtinme-Ri-Tenderim “

Nr i Prokurimit 617-20-8108-1-3-6

Nr i brendshëm 617-2020-102-136

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë

“ Furnizimi -Tepih dhe Perde për hapjen e objektit të ri të I.P “Albiona Asllani”- Shtinme-Ri-Tenderim “

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 16.12.2020 dhe përfundon me 31.12.2020

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 130 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë : *Institucionet e cekura në paramasë.*

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 3,807.80 € (Tremijë e tetëqindë e shtatë euro e tetëdhjetë cent)

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë (Faturë) nga OE, dhe raporti i Menaxherit të Kontratës të caktuar nga AK për furnizimin e kryer .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për NA

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik



Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Bajram Avdyli	Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.12.2020	Data:	16.12.2020
Vula:		Vula:	




Specifikacion- Furnizim me tepih dhe perde për hapjen e objektit të ri të I.P "Albiona Asllani"- Shtime

Nr	Foto	Pershkrimi	Nj matse	Sasia	Cmimi ME TVSH	Shuma ME TVSH
1		Tepison (ngjyre krem- kafe e qelet) pa gome Canon me fills (madhesite prehen ne vendin e ngjarjes si dhe te gjitha pjeseve te prera te l'u kthehet rrethi/ qepen me makine)	m2	221	4.30 €	950.30 €
2		Tepih si ne foto 4mx3m (Akryl 100%)	cope	4	90.00 €	360.00 €
3		Tepi e rrumbullaket 120cm (5x 5 ngjyra- e bardhe, e verdhe, lejla, e kuqe, e gjelbert)	cope	25	14.90 €	372.50 €
4		Perde Kefen me pika (ngjyre krem) me qepje pas konsultimit me institucionin	m	200	4.50 €	900.00 €
5		Varese per perde (2 cope per nje dritare/ dere terase)	komplet	50	4.00 €	200.00 €

6		Roleta ngjyre kafe e qelet si ne foto (me montim)	m2	55	17.00 €	935.00 €
7		Shtroje gome ne parahyrje 1.60 x 0. 80 cm	cope	10	9.00 €	90.00 €
					Shuma :	3,807.80 €

Vërejtje: Operatori ekonomik i cili shpërblehet me kontratë, për të gjitha specifikat e paisjeve në këtë specifikacion duhet të konsultohet paraprakisht gjatë furnizimit me drejtorin e institucionit dhe meaxherin e kontratës deri të kryhet i tërë furnizimi.

Emri i Kompanisë	GRYKA SH.P.K
Adresa e Plote	RR.ANTON ÇETA - SHITINE
Përfaqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	BAJRAM AVDYLI
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Data	07.12.2020
Vula	